

e lajmeve, KIC, 6.07.1998, FDH-29354; *At Least 10 Albanians Killed in Kosova During the Last Week*, pasqyra e lajmeve, KIC, 7.07.1998, FDH-29355; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; fotografi, FDH-36673.

Hashim (Zeqir) Trmkolli

(4.06.1933, shqiptar nga Bardhi i Madh/Veliki Belačevac, komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, gjashtë fëmijë, punëtor në depo)

Në fillim të muajit qershor të vitit 1998, familja e Hashimit, me urdhër të forcave serbe e braktisi fshatin **Bardh i Madh/Veliki Belačevac**. Po ashtu, fshatin e kishte braktisur edhe shumica e banorëve, por Hashimi nuk dëshironte që ta braktiste shtëpinë. Ai ndenji me vëllezërit Halimin dhe Brahimin, si dhe djemtë e tyre. Në datën **27.07.1998**, Hashimi me dajën Ejupin e kishin lëshuar bagëtinë në kullotë, në vendin e quajtur *Kalaja/Zidine*, afër lumit. Me atë rast, pjesëtarët e forcave serbe hapën zjarr drejt tyre. Ejupi u plagos në këmbë, ndërsa më pas Hashimi u qëllua në kokë dhe në këmbë. Ai së shpejti ndërroi jetë. Halimi dhe Brahimi, po atë ditë, me leje të policisë e morën trupin e Hashimit dhe e varrosën në varrezat e fshatit. Në muajin shtator të vitit 2000, patologët e Hagës e kanë kryer zhvarrosjen e mbetjeve mortor të Hashimit. Ekzaminimet profesionale mjekësore janë kryer në Institutin për Mjekësi Ligjore në Rahovec/Orahovac. Në shtator të vitit 2000, familjarët i morën mbetjet mortore të Hashimit dhe i rivarrosën në varrezat në Bardh të Madh/Veliki Belačevac.

Burimi: deklarata B.T, FDH-14494.

Fejzullah (Salih) Sogojeva

(1941, shqiptar nga Graboci i Ulët/Donji Grabovac, komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, shtatë fëmijë, gomist)

Në luftë, Fejzullahu i ndihmonte UÇK-së, duke gërmuar istikame dhe duke u dërguar ushqime dhe rroba. Në datën **15.08.1998**, ai gërmonte istikame në **Graboc të Ulët/Donji Grabovac**. Për një çast e ndërpreu punën për ta dëbuar bagëtinë, që kishte hyrë në arën e tij. Derisa po kalonte

përmes arës së Arben Statovcit, u qëllua nga një plumb snajperi. Fqinji i tij, Cen Sogojeva, me bashkëshorten e tij e futën në shtëpi, ndërsa më pas e dërguan me veturë në Gradicë/Gradica [Glllogoc/Glogovac], në spitalin e UÇK-së. Aty qëndroi 2-3 ditë, nga u transferua në spitalin e Prishtinës/Priština, kurse një ditë më vonë në spital në Beograd. Fejzullahu ndërroi jetë pesë ditë më vonë. Në datën 4.09.1998, trupi i tij u kthye në Prishtinë/Priština, ku edhe u varros në varrezat në *Dragodan*.

Burimi: deklarata C.S, FDH-14491.

Salih (Sejdi) Topalli

(1936, shqiptar nga Fushë Kosova/Kosovo Polje, pensionist, pesë fëmijë.)

Në datën **26.09.1998**, Salihu u nis për ta përcjellë nipin e tij Ismetin, i cili kishte ardhur për vizitë tri ditë më parë. Ata u nisën në drejtim të Bajicës/Banjica [Glllogoc/Glogovac], ku gjendej familja e Ismetit. Kur arritën në pyll, afër fshatit **Sllatina e Madhe/Velika Slatina**, kishin parë shtëllunga tymi dhe kanë dëgjuar të shtëna. Ismeti e kishte vazhduar rrugën, kurse Salihu u kthye. Po atë ditë, Ismeti e ka takuar një burrë nga Korrotica e Epërme/Gornja Koretica [Glllogoc/Glogovac], i cili kishte qenë me Salihun në pyll afër Sllatinës së Madhe/Velika Slatina. Ai i kishte thënë se forcat serbe kanë shtënë dhe e kanë qëlluar Salihun, me ç'rast ai ka mbetur i vdekur në vend. Pas disa ditësh, Ismeti ka mësuar se Mehmet Xharrahu, më 26.09.1998, e ka gjetur trupin e Salihut dhe e ka varrosur në pyll. Pas luftime, në qershor të vitit 1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Salihut në varrezat e vendlindjes së tij në Bajicë/Banjica.

Burim: deklarata R.V, FDH-16518.

Desimir (Dušan) Prodanović

(17.04.1969, serb nga Prishtina/Priština, inxhinier)

Desimiri ishte me prejardhje nga Foça [BdheH]. Punonte në minierën *Bardh i Madh/Belačevac*. Në datën **3.11.1998**, rreth orës 18:00, shkoi në **Graboc të Ulët/**